



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:019136

Datë: 04.03.2025

Numri i dokumentit: 06937685

**C.nr.437/2018**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Gazmend Ajvazi, me bashkëpunëtoren profesionale Laureta Sh në çështjen juridike kontestimore të paditësit N M nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Mustafë Musa, avokat nga Gjilani, kundër të paditurve A M, A M, A M, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Shabi Isufi, avokat nga Gjilani, J M , M M, M M të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Feim Alaj avokat nga Prishtina, av. Halit Azemi avokat nga Gjilani, M M dhe A M, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson A Salihu, avokat nga Gjilani, Xh M fshati K K. K, M.K fshati K K. K dhe F.LL nga fshati R K. K, me objekt kontesti kthimi i palujtshmërisë ose kompensimi i paluajtshmërisë, vlera e kontestit 90,650.00€, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor e publik, më datë 29.01.2025 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit N M , nga Gjilani, e të cilën ka kërkuar që të **DETYROHEN** të paditurit A M, A M, A M, J M, M M, M M, M M, të gjithë nga Gjilani, Xh M nga fshati T. K. Ks, M.K fshati K K. K dhe F.LL nga fshati R K. K, që paditësit në emër të kompensimit të paluajtshmërisë t'ia kthejnë pjesën e sipërfaqes së parcelës kadastrale 593/1 në sipërfaqe prej 518m<sup>2</sup> në vendin e quajtur "P." ZK Gjilan, ose t'ia kompenzojnë këtë ngastër në shumën e përgjithshme prej 90,650.00€, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

**II.** Obligohet paditësi që të paguaj shumën prej 2,704.00€, per shpenzimet e krijuara per perfaqësuesin e përkohshëm, në gjirollogari të Av. Shabi Isufi nga Gjilani.

Gjithashtu në emër të shpenzimeve të procedurës Av. Halit Azemit t'ia paguaj shumën prej 4,680.00€, Av. Feim Alaj, t'ia paguaj shumën prej 2180€ dhe av. A Salihut t'ia paguaj shumën prej 1,144.00€, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm

**A r s y e t i m**

**Pretendimet e palëve ndërgjyqëse:**

Paditësi përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar padi kundër të paditurve, me objekt kontesti kompensim i paluajtshmërisë- parcelës kadastrale 593/1 në sipërfaqe prej 518m<sup>2</sup> në vendin e

quajtur “Popovica” ZK Gjilan ose kompensimin e shumës prej 90,650.00€, nëse nuk bëhet kthimi i pa luajtshmërisë.

Si në seancën pergaditore, në atë kryesore si dhe në spjegimet përfundimtare përfaqësuesi i paditësit **av. Mustafë Musa** ka deklaruar në tërësi mbetemi pranë padisë dhe kërkespadsisë dhe pranë precizimit të kërkespadsisë, thenjeve të cekura në seancat e më parshme. Nga provate e administruara dhe fakteve të vërtetuara padyshim është vërtetuar bazueshmeria e kërkespadsisë, dhe i propozoj gjykatës si të tillë ta aprovoi. Në këtë qështje kontestuese ekziston Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.330/2000 i datës 15.01.2001 dhe i plotfuqishëm me datë 15.08.2001, ku paraardhësit të paditësit të ndjerit D. M, i ishte njohur e drejta e pronësisë, në ngastrën kadastrale 593/1 në sip. prej 0.05,18 ha. Pyetjet e shtruara nga ana e përfaqësuesve të të paditurëve në seancë ishin jolëndore pasi që kishin të bëjnë me pronësinë e pjesës së palës paditëse e cila është gjë e gjykuar sipas Aktgjykimit 330/2000. Sipas këtij aktgjykimi vërtetohet baza juridike e kërkespadsisë por kishin munguar masat dhe kufijt e pjesës së gjykuar të parcelës kontestuese dhe se gjendja në teren kishte ndryshuar pasi që në pjesën lëndore që i kishte takuar paditësit, të paditurit kishin ndërtuar shtëpi.

Në favor të aktgjykimit të përmendur ishin deklaruar edhe dëshmitarët M Sh dhe B M si dhe deklarata e paraardhësit të paditësit tani të ndjerit D M nga e cila vërtetohet se D M dhe paraardhësi i të paditurëve A M tani i ndjeri M kishin blerë palujtshmërinë kontestuese nga e cila sipërfaqja prej 518m<sup>2</sup>, e cila gjendet në anën lindore, e parcelesi kishte takuar të ndjerit D-paraardhësit të paditësit.

Nga dëshmia e të ndjerit M të dhene me shkrim, të nënshkruar nga ai vet, vërtetohet se Di dhe Ji ja kishin shitur ngastrën kontestuese por se Ji e kishte uzurpuar në teren pra edhe pjesen e Dit dhe kishte filluar të ndërtoi shtëpi dhe se Dit i kishte takuar hyrja nga rruga kryesore Gjilan – Prishtinë. Me Aktgjykimin C.nr.399/2002 të datës 06.05.2003i bërë i plotfuqishëm me datën 11.12.2003, vërtetohet se kontratën që e ka prezentu M M C.nr.1218/2002 të datës 15.06.2002 ishte anuluar.

Meqenëse paraardhësi i paditruve J M kishte filluar të ndërtojë edhe në pjesën e pronës së palës paditëse, Aktgjykimi i plotëfuqishëm C.nr.330/2000, i datës 15.01.2001, nuk kishte mundur të zbatohet në procedurë përmbarimi sipas Aktvendimit për lejimin e përmbarimit E.nr.1571/2001 i datës 10.09.2001, ndërsa paraardhësi i paditësit nuk kishte pushuar duke ushtruar mjete juridike dhe se me Aktvendimin AC.nr.333/2011 ishte bërë i plotëfuqishëm Aktvendimi i procedurës përmbarimore se nuk mund të ekzekutohet Aktgjykimi i plotëfuqishëm C.nr.330/2000. Pas pranimit të këtij Aktvendimi me datën 19.12.2011, paraardhësi i paditësit me datën 23.12.2011, ushtron padi për kompensimin e palujtshmërisë pra vetëm pas 4 ditëve, ashtuqë këtu lidhet kontinuiteti i rrjedhshmërisë se afatit pra jo siq cekin të autorizuarit e palëve prej vitit 2001 por prej vitit 2011, ashtuqë në asnjë mënyrë nuk mund të thuhet se kemi parashkrim të kërkesë padisë, meqenëse pronësia është e drejtë absolute atëherë të gjitha kërkesat që burojnë nga e njëjta nuk i nënshtohen institutit të parashkrimit, e që si rast i ngjajshëm është marrja e pronësisë epër interes t epërgjithshëm pa u shpallur intersi i përgjithshëm dhe pa u zhvilluar procedura e shpronësimit nga ana e organit shtetëror, po në rastin konkret kemi t ëbëjmë me uzurpim të pronës, në të cilën është bërë ndërtimi, për këtë qështje kemi edhe qëndrimin e Gjykatës Supreme.

Sipas vlerësimit të ekspertit gjeodet Artan Zeneli vërtetohet se pjesa më e madhe e parcelës kadastrale nr.5093/1, është truall dhe ndërtesë, atëherë edhe vlerësimi i grupit të ekspertëve të ndërtimtarisë Zeqirja Fazliu, Bashkim Hoxha dhe Naim Imeri është objektive dhe e punuar me të arriturat shkencore bashkohore nga lëmia e ndërtimtarisë, të cilët kan vlerësuar shumën prej 90,650.00€, në emër të pjesës së parcelës 593/1 me sipërfaqë prej 518m<sup>2</sup>, me qka edhe është vërtetuar lartësia e kërkesëpadsisë janë të paqëndrueshme të gjitha pretendimet palëve të paditura të cekuar në seancë në drejtim të vërtetimit të pronësisë, veq një bazë e tillë është

gjykuar me Aktgjykimin C.nr.330/200, pra kemi të bëjmë me gjënë e gjykuar “Res Judicata”. Nga të cekurat si më lartë propozojmë që gjykata ta aprovojë kërkesëpadinë sa i përket kompensimit të paluajtshmërisë në tërësi si themel pra shumën prej 90,650.00€ me kamatë prej 8% duke llogaritur nga dita e punimit të ekspertizës nga grupi i ekspertëve nga data 20.07.2013 e deri në pagesën definitive. Si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës për taksën për padi 540€, shpenzimet për përfaqësuesin e përkohshëm në shumë prej 8500 €, për dy ekspertiza shumë prej 800.00€, shpërblimi i avokatit për 10 seanca 1,406 € shumë prej 4.060€, shpërblimi i ekspertit gjeodet shumë prej 300.00€ në total shumë prej 14.200€.

Përfaqësuesi i përkohshëm **Av. Shabi Isufi** si në seancat e mbajtura përgatitore dhe në atë kryesore si dhe fjalën përfundimtare, ka deklaruar se nga provat e prezentuara dhe të elaboruara nga ana e gjykatës dhe shqyrtimet e mbajtura deri më tani mbetem në tërësi pranë theksimeve si në seanca, si dhe pranë kundërshtimeve sa i përket pretendimeve të paditësit në padinë e ushtruar pranë kësaj gjykate. Nisur nga fakti se kjo qështje kontestimore është kthyer në rigjykim nga Gjykatata e Apelit me sygjerimet e sajë dhe detyrat se si duhet të veprojnë Gjykata e Shkallës së Parë detyrat që duhet ti përmbushë andaj edhe për këtë arsye gjykata padinë dhe kërkesë padinë e paditësit duhet ta refuzojë si të pabazuar, për shkak të mosveprimeve sipas sygjerimeve të Gjykatës.

Edhe nga deklarimet e të autorizuarve të të paditurëve tjerë, vërtetohet se paditësi nuk ka arritur të vërtetojë faktin se në bazë të të cilës provë dhe fakti të vërtetuar të kërkojë vërtetimin e pronësisë dhe kompensimin e saj. Se padia dhe kërkesëpajda e paditësit është e pabazë, vërtetohet edhe me faktin se i njëjti gjatë shqyrtimeve gjyqësore nuk len të kuptohet se qka kërkon, a kërkon vërtetimin e pronësisë apo kompensimin, pasi që disa herë ka bërë parashtrësia për precizimin e padisë, në fund nga e gjitha që është theksuar më lartë propozojë gjykatës që ta refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për 4 seanca të mbajtura shumë prej 540.80€ për qdo seancë të mbajtur, për 2 seanca të treguara nga 270.40€, në shumë të përgjithshme prej 2,704.00€.

Përfaqësuesi i të paditurve **av. Feim Alaj**, si në seancat e mbajtura, në atë përgatitore, kryesore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar, se kundërshtojmë pretendimet e paditësit për kthimin e pjesës së ngastrës 593/1 në sipërfaqe prej 518m<sup>2</sup> ose kompensimin e kësaj paluajtshmërie, duke argumentuar se paditësi nuk ka pasur kurrë titull pronësie mbi këtë ngastër dhe pretendimi i tij është në kundërshtim me Ligjin Për Marrëdhëniet Juridiko Civile dhe Ligjin për Pronësi dhe Të Drejtat Sendore si dhe Afatet Ligjore Të Parashkrimit. Pretendimi i paditësit është se paluajtshmëria është uzurpuar ashtu që i duhet dëmshpërblimi financiar ose kthimi i pronës. Paditësi asnjëherë nuk e ka pasur në posedim efektiv këtë pronë, ashtu që edhe nuk ka asnjë provë që vërtetojnë posedimin e mëparshëm por ka ushtruar padi për kompensim duke tejkalluar afatet Ligjore të parashkrimit sipas LMDS neni 352, ku afati i përgjithshëm i parashkrimit për kërkesat për kompensim parashkruhen për 5 vite. Sipas rregullave të trashëgimisë ligjore të drejtë për të ushtruar padinë mbi pronën e lënë në trashëgim ka vetëm trashëgimtari, duke dëshmuar se është trashëgimtarë i ligjshëm andaj paditësi nuk ka vërtetuar në asnjë akt juridik se është trashëgimtarë i vetëm ai ka autorizime prej bashkësisë familjare të të ndjerit D M, gjë që vihet në dyshim nga pala e paditur. Ndryshimi i padisë në fazën të avancuarë të procesit në seancën e shqyrtimit kryesorë dhe atë para dhënies së fjalës përfundimtare është lejuar ndryshimi i padisë në kundërshtim me nenin 258 të LPK-së. Paditësi në padinë e tijë të datës 23.12.2011, ka kërkuar nga të paditurit që në kuptim të dispozitave ligjore të LMD-së, t’ia paguajë vlerën reale të sipërfaqes prej 0.05.18ha, të pronës kontestuese mirëpo paditësi nuk ka specifikuar dispozitat ligjore mbi të cilat mbështet kërkesën. Padia është dorëzuar jashtë afatit ligjorë, pasi që Aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm më datën 15.08.2001 ndërsa padia është

dorëzuar me datën 23.12.2011, dhe se kjo e bënë si të pasafatshme padinë sipas LMD-së neni 352.

Propozimi për përmbarrim për ekzekutim të Aktgjykimit C.nr330/2000 është hedhur poshtë për papërshtatshmërinë me 20.06.2001, sipas nenit 391 pika F, hedhja poshtë e padisë është bazuar në faktin se Vendimi Gjyqësorë ka marrë formën e prerë me datën 15.08.2001, ndërsa padia është gënjtur me 23.12.2011, cka nënkupton se kanë kaluar mbi 10 vite. Hedhja poshtë e propozimit për përmbarrim paditësi ka marrë dijëni se titulli nuk është i përshtatshëm për ekzekutim andaj edhe nëse meret momenti i dijenisë afati 3 vjeçar për kërkesë kompensimi përfundon me datën 20.06.2004 ndërsa padia është bërë në fund të vitit 2011. Dhe nëse llogaritet data kur është vërë në dijenit paditësi dhe momenti i pamundësisë së ekzekutimit, mosveprimi i Gjykatës për parashkrim e që është ngritur në seancën përgatitore Gjykata ka mundur të marrë Vendim në këtë qështje duke refuzuar padinë për shkak të parashkrimit. Afati relativ prej 3 viteve ka kaluar në vitin 2004 dhe se qështja e parashkrimit është diskutuar gjerësisht, gjykata nuk ka marrë vendim por ka shtyrë qështjen për vendim përfundimtarë në një seancë tjetër. Afati i parashkrimit mund të ndërpritet nëse subjekti paraqet një kërkesë pranë gjykatës kompetente ndërsa kërkesa nëse refuzohet ose mbetet pa efekt afati vazhdon të llogaritet nga fillimi e që kemi të bëjmë me vitin 2000 ku edhe është nxjerrë Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan- Dega K, e që palët e kundërshtojnë këtë Aktgjykim. Kërkesa për kompensim pas kalimit të afatit prej 3 viteve nga momenti kur pala merë dijenit për pamundësinë e posedimit atëherë kërkesa mund të konsiderohet e parashkruar nëse pretendimi për kompensim është bërë pas vitit 2004 për një ngjarje që ndodhi në vitin 2001, andaj Gjykata ka mundur ta trajtojë si të jashtë afatit ligjorë sipas LMD-së.

Sipas LPK-së, ndryshimi i padisë bëhet vetëm nëse nuk ndryshon baza juridike e kërkesëpadisë dhe nëse nuk i vendos të paditurit në një pozite pa favorshme mbrojtjeje. Në fillim kërkesa ka qenë për rkompensim të paluajtshmërisë ndërsa në fund paditësi kërkon kthimin e pronës ose kompensimin, ku ky ndryshim ka të bëjë me ndryshimin e natyrës së padisë pasiqë paditësi po kërkon një të drejtë reale, mbi pronën andaj ndryshimi është i kundërligjshëm dhe së gjykata nuk është dashur ta lejoje pasiqë shkelet parimi i sigurisë juridike.

Sipas LPDS-së, e drejta e pronës fitohet nëse është regjistruar në kadastrë dhe se paditësi nuk ka qenë asnjëherë i regjistruar si pronarë në librat kadastralë, për pronën në fjalë andaj edhe nuk mund të kërkohe kthimi i pronës që nuk është regjistruar asnjëherë në emër të paditësit.

Paditësi ka tentuar ta vëjë në lajthim duke u thirru në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KI212/21, nr.ref.AGJ2216/23 faqe 7 pasuesi i V nr.50 është i patolerueshëm, pasiqë në këtë aktgjykim përcaktohet qartë se një vendim që bazohet në pretendime të paqarta mbi pronësinë nuk mund të ekzekutohet. Paditësi ka dhënë një deklaratë kontradiktore gjatë marrjes në pyetje lidhur me posedimin dhe shfrytëzimin e pronës, gjë që e dobëson pretendimin e tij për kompensim ku në disa seanca ka deklaruar se ka qenë në posedim të pjesës së pronës ndërsa në të tjerat ka mohuar se prona është uzurpuar nga të paditurit gjatë procesit gjyqësor është vërtetuar se i njëjti nuk ka qenë kurrë në posedim, nuk ka pasur të drejtë faktike mbi këtë pronë, andaj deklaratat kontradiktore të tijë dëmtojnë kredibilitetin mbi të drejtën që pretendon. Është e dyshimtë kompetenca e Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega e Ks dhe se në vitin 2000 procedura ka vazhduar në Degën e Ks, prona nuk ka lëvizur nga vendi dhe tani është në Komunën e Gjilanit, andaj si qështje është dashur të shqyrtohet në bazë të vend ndodhjes në bazë të paluajtshmërisë dhe se Vendimi është marrë nga një Gjykatë jo kompetente e i cili nuk mund të prodhojë asnjë efekt juridik. Bazuar në të cekuar më lartë pas amdinistrimit të provave ku vërtetohet se paditësi nuk ka asnjë bazë ligjore, që ti jipet e drejta për kthim të pronës apo kompensimin e sajë vijnë në përfundim se të gjitha pretendimet e paditësit janë të pabazuara, andaj edhe gjykata duhet të refuzojë në tërësi si të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe se e njëjta edhe nuk ka bazë ligjore edhe nuk është e mbështetur në prova.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas tarifës së OAK-së për pjesëmarrjen në 7 seanca nga 312€ gjithsej shumën prej 2184€.

Përfaqësuesi i të paditurve **Av.Halit Azemi** si në seancat e mbajtura në atë përgatitore, kryesore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se më aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.330/2000, i datës 15.01.2001, është aprovuar kërkesëpaidea e paditësit për shkak të mungesës së paditurit M kurse ndaj të paditurit J M është hequr dorë nga kërkesëpadia, ashtu që në bazë të këtij Aktgjykimi të marur në mungesë e cili është bërë i plotfuqishëm 15.01.2001, në procesverbalin dhe Aktgjykimin ka pushuar kërkesëpaidea e paditësit ndaj të paditurit J. Heqja dorë nga kërkesëpadia ndaj të paditurit J, konsiderojm se ndaj trashëgimtarëve të tijë nuk mund të ushtrohet padi dhe se të paditurit nuk kanë legjitimitet pasiv, për shkak të heqjes dorë nga padia dhe se nuk mund të inicohet procedurë tjetër për të njëjtën kërkesëpadi andaj edhe gjykata duhet ta hedhë poshtë si të palejuar. I padituri J M nuk është trashëgimtarë i të ndjerit por janë fëmijet e tijë të rendit të parë të trashëgimisë dhe se i padituri J nuk ka lejgjitimitet pasiv dhe as femijet e tijë, andaj të njëjtit nuk mund të marin obligime dhe borxhe por si përgjegjës për obligime dhe borxhe mund të paraqiten vetëm trashëgimtarët e rendit ligjorë, të shpallur të cilët kanë trashëguar pasurinë e paluajtshme dhe të luajtshme. Nuk ka asnjë njohur që është zhvilluar ndonjë procedurë trashëgimore lidhur me trashëgiminë e të ndjerit M. Gjithashtu nuk ka prova materiale se pas vdekjes së të ndjerit D M a është rregulluar trashëgimia dhe cilët persona janë shpallë trashëgimtarë dhe qka është lënë nga masa trashëgimore, që të dihet se pala a ka legjitimitet aktiv, për të qenë palë në procedurë.

Të gjitha këto prova janë relevante që gjykata paraprakisht ti vërtetojë se cilat palë kanë legjitimitet pasiv, për të qenë palë në procedurë dhe cilat nuk kanë legjitimitet. Gjithashtu e kontestojmë edhe ekspertizën e ekspertëve të vlerësimit, pasi që nuk merret për bazë qmimi i tanishëm si tokë ndërtimi ngase në vitin 1984, ishte arë dhe nuk ka pasur asnjë objekt në atë lagje dhe se nëse i caktohet qmimi duhet të jetë revalorzim ngase nuk mund të jetë qmimi i njëjtë sikurse i tokës me kulturë arë dhe tani të vlerësuar si tokë ndërtimore që paraqet kontradiktë në mes veti, ashtu që në vitin 1989 është bërë rregullimi si tokë ndërtimore me kontratën e datës 27.06.1989, me BVI sepse në bazë të fletës poseduese dhe kopjes së planit të vitit 1986 me kulturë ka qenë arë ndërsa në bazë të ekspertizës së vlerësimit ngastra është vlerësuar si tokë ndërtimore në këtë periudhë kohore. I padituri J objektet i kishte ndërtuar në bazë të lejes përkatëse të lëshuar nga organet kompetente të Drejtorisë për Urbanizëm i cili ka ndërtuar objekte për banim pa u penguar nga askush e në të cilat jeton sot e kësaj dite, duke e paguar edhe tatimin në pronë ashtu që nuk ka asnjë provë ose dëshmi materiale që paditësi tani më i ndjerë D M, ta ketë blerë një pjesë nga i padituri tani i ndjerë M e i cili sa ishte gjallë ka dhënë dëshmi pranë gjykatës së asnjëherë nuk ia ka shitur paditësit D e për qka edhe aktgjykimi C.nr.330/20 ishte marrë në mungesë të të paditurit e i cili nuk ishte njoftuar në mënyrë të rregullt siq ka deklaruar edhe vet i padituri sa ishte në jetë. Deklarata e paditësit N është shumë kontradiktore saqë jep me konkludu se fare nuk ka blerë D M paluajtshmëri pasi që nuk ka hyrë asnjëherë në posedim dhe shfrytëzim të paluajtshmërisë, i njëjti nuk ka dalur asnjëherë të shohë së cilën pjese e ka blerë dhe se nuk e din fare se nga cila anë e arës është blerë në atë kohë, ndërsa i padituri J në bazë të mbajtjes me parashkrim fitues e ka fituar të drejtën e pronësisë në mënyrë të ndërgjegjshme dhe me leje ndërtimore ka ndërtuar shtëpi pa kurfare pengese dhe se nuk ka asnjë obligim ndaj askujt. Propozojmë që kërkesëpadia e paditësit me të cilën fillimisht ka kërkuar paditësi të drejtën e pronësisë dhe se pastaj e ka ndryshuar në kuptimin objektiv disa herë pa bazë ligjore duke kërkuar që të kompensohet në të holla është i pa bazuar ngase kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës si dhe padinë në kuptimin objektiv mund ta ndryshojë sipas nenit 258 të LPK-së, deri në përfundim të seancës përgatitore, ku e njëjta mund të ndryshohet vetëm nëse jepet pëlqimi nga ana e të paditurit. Nuk ekziston asnjë bazë e vetme për aprovimin e kërkesëpadisë ndaj të paditurve J dhe M M dhe djemve të tij duke pasur parasysh se i padituri J

nuk ka qenë në kurfarë raporti kontraktuar me paditësin por edhe me aktgjykimin e lartëpërmendur ka hequr dorë nga kërkesëpadia. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për 13 seanca nga 312€ në shumën prej 4,056.00€, për tri ankesa nga 208€ në shumën prej 624€, për tri përgjegje në padi nga 135€ shumën prej 405€, të gjitha në shumën prej 5,085.00€.

Përfaqësuesi i paditurve **Av.A Salihu** si në seancat e mbajtura në atë përgaditore dhe kryesore si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar: Fillimisht paditësi D M më dt.23.12.2011, ka deponuar padi për kompensim të paluajtshmërisë në Gjykatën Themelore në Gjilan, dhe ia ka bashkangjiur provën materiale Aktgjykimin C.nr.330/2000 me nr. te ekzekutimit E.Nr.1571/2001 . Baza e padisë ndërlidhet me vendimin e formës së prerë të Aktgjykimit të dt.15.01.2001 i cili është bërë i plotëfuqishëm më dt.15.08.2021 ndaj le të kuptojmë se ligji në kohën kur është bërë i plotëfuqishëm e deri në deponimin ose dorëzimin e padisë nga paditësi ka qenë LMTHJP të Ish Jugosllavisë, i dt.01.09.1980, e i cili ka vepruar deri më dt.25.06.2009, e i cili gjithaashtu ka rregulluar saktë të drejtën e kërkesës për kompensimin e paluajtshmërisë neni 24 i këtij ligji. Në rastin konkret pronari i cili pretendon se e ka fituar të drejtën e pronësisë sipas vendimit gjyqësor i plotëfuqishëm më dt.15.08.2001 i ka ikur afati përfundimtar prej 10 viteve, sipas dispozitave të nenit 24 par.2 me qrast i është arashkruar e drejta e kërkesës për komensim të paluajtshëmrisë, ku sipas kalkulimit kanë kaluar 10 vjet e 4 muaj e 8 ditë, e që do të thotë se padia është paraqitur pas afatit andaj gjykata duhet ta hedhë poshtë si të pasafatshme. Si bazë tjetër për hudhjen e padisë si të pasafatshme është edhe fakti se aktgjykimi është bërë i plotëfuqishëm më dt.15.08.2001 ndërsa padia është dorëzuar më dt.23.12.2011, pasi që afati i parashkrimi sipas nenit 352 të LMD-së, parashihet se kërkesat parashkruhen për 5 vjet , në qoftë se me ligj nuk është caktuar afat tjetër i parashkrimit ose sipas nenit 361 kërkesat që janë vërtetuar nga gjykata me vendim të formës së prerë ose të organit tjetër kompetent parashkruhen për 10 vjet .

Përfaqësuesi i paditësit më dt.20.11.2024 ka deponuar parashtrësën për ndryshim të padisë në aspektin objektiv pasi që ka vërejtur se i është parashkruar e drejta për kompensim, në këtë parashtrësë i autorizuari i paditësit potencon faktin se e drejta sendore është absolute andaj të gjitha kërkesat që burojnë nga e drejtë e pronësisë nuk parashkruhen asnjëherë, andaj me të vërejtur se është deponuar një parashtrësë më dt.25.11.2024 nga e cila është elaboruar më lartë propozimi për hedhjen poshtë të padisë, i autorizuai i paditësit bën ndryshimin e padisë në aspektin objektiv ku përveq kompensimit kërkon edhe kthimin e palautshmërisë ku e gjithë kjo bëhet për të tentuar ta mënjanojë dështimin e orientimit të gabuar të padisë, me të cilat unë nuk e kam kontestuar procedimin e qdo veprimi juridik sa i përket të drejtës sendore e cila është natyrisht absolute mirpo e kam kontestuar afatin e parashkrimit ose vjetërsimit të se drejtës në kërkim të kompensimit të dëit sepse vet përfaqësuesi i paditësit është thirrë në LMD. Unë e kam kundërshtuar ndryshimin e paidsë në seancën e dt.29.01.2025 mbi bazat e neneve 258 par.2,3,4,5,6 të LMD-së, pasi që sipas këtyre neneve paditësi mund ta ndryshojë padinë më së voni deri në përfundim të seancës përgaditore ose më së voni deri në mbylljen e seancës për shqyrtim kryesor më kusht që pala e paditur të pajtohet me ndryshimin e padisë. Në seancën e dt.29.01.2025 i dëgjuar në cilësi të palës paditësi ku gjatë dëshmisë së tij, nuk është vërtetuar fakti se prona kontestuese ka qenë ndonjëherë pronë e babait të tij D M, dhe më asnjë provë materiale me të cilën do të mund të vërtetohej e drejta e tij subjektive lidhur me pronën, e i cili në procesverbalin e dt.29.01.2025 faqe 5 pasuesi i 8-te, përgjigjet “se ska njohuri deklaron për një kontratë në gjykatë, mirpo kjo provë askund në shkresat e lëndës nuk figuron” pas pyetjes së bërë nga Av. A Salihu se keeni ndonjë dikument ose kontratë që vërtetohet se babai i juaj të ketë qenë pronar i pronës kontestuese dhe i njëjti përgjigjet se nuk ka asnjë dokument se prona është e babait të tij.J M dhe familja e tij pronën e kanë poseduar dhe shfrytëzuar për me tepër se 50 vjet duke paguar kontributet komunale ku edhe ka ndërtuar shtëpi andaj edhe paditësi nuk ka asnjë provë në bazë të të cilit do të bazohej kërkesa për kompensimin e paluajshëmrisë. Në fund

gjykatës i ka propozuar që të refuzojë kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përgjegjen në padi shumën prej 406.25€ dhe për tri seanca të nbajtura nga 422.50€ e në total shumën prej 1,673.75€.

### **Provat e administruara në shqyrtimin kryesor :**

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave i ka administruar këto prova: Dëshmia e nënshkruar nga paraardhësi i paditësit dhe paraardhësi i të paditurve ( M dhe D M), Aktgjykimi i plotfuqishëm C.nr.330/2000 i dt.15.01.2001, Aktgjykimi i plotfuqishëm C.nr.399/02 i dt.06.05.2003, te Ish Gjykatës Komunale në Gjilan , me të cilën është kontratat e lidhur për falje e lidhur ndërmjet dhuratëdhënësit M dhe dhuratëmarrësit J M e vërtetuar tek Gjykata Komunale në Gjilan, VR.Nr.1218/2002 e dt.15.06.2012, Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, REV.Nr.107/20 i dt.24.05.2005, me të cilën është ndryshuar Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan AC.Nr.64/2004 i dt.30.03.2004 dhe ai i Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.320/2003 i dt.04.12.2003, dhe është hedhur si i paaftshëm propozimi i të paditurit për përsëritjen e procedurës, Kopja e planit pa nr. e dt.18.03.1986, Aktvendim i Gjykatës Komunale në Gjilan, E.Nr.157/2001 i dt.20.06.2001, me të cilën është shfuqizuar Aktvendim i kësaj gjykate Nr.157/2001 i dt.10.09.2001, me të cilin ishte lejuar ekzekutimi aktgjykimit C.nr.330/2000 dhe propozimi për përmbarrim është hedhur poshtë për shkak të papërshtatshmërisë së dokumentit ekzekutiv për ekzekutim, Aktvendim i gjykatës së Qarkut në Gjilan, AC.NR.333/2001 i dt.17.11.2011, me të cilin është vërtetuar aktvendimi E.Nr.1571/2001 i dt.20.06.2011, Aktvendimi C.nr.599/02 i dt.16.02.2002 me të cilin është konsideruar padia e paditësve e J M kundër të paditurit D M nga Gjilani e tërhequr si dhe aktvendimi për pengim posedim C.nr.338/85 sipas padisë së paditësit D M kundër të paditurit J M, Certifikata e pronës me nr.1676/2019 e dt.01.03.2019, Aktvendimi për rregullimin e trashëgimisë s të ndjerit D M LRP.Nr.111/2018 , Ref.T.nr.500/2018 e dt.23.08.2018 ku për trashëgimtar të vetëm është shpallur tani paditësi N D M, Aktvendimi për pengim posedim C.nr.308/85, Ekspertiza e ekspertit ë ndërtimtarisë nga eksperti Hamdi Ismajli nga Gjilan ie dt.18.04.2013, Ekspertiza nga grupi i ekspertëve e dt.20.07.2013, deklarata e palëve D M dhe J M të dhënë në procesverbalin e dt.16.01.2013, Deklarata e dëshmitareve M Sh dhe B M të dhënë në procesverbalin e dt.16.01.2013, Ekspertiza e gjeodezisë e dt.02.05.2019 me 6 skica, Procesverbalin C.nr.330/2000 si dhe aktgjykimin C.nr.330/2000 i dt.15.01.2001, Ekspertiza plotësuese e dt.29.11.2024, Përgjegjja e DGJKP-së në Gjilan e dt.02.12.2024 lidhur me ngastrën kad.293-1, Kopja e planit për ngastrën 593-1 e dt.11.12.2024 në tri faqe Lexohet dhe administrohet Kontrata mbi rregullimin tokës ndërtimore me nr.01352-1355/89 e dt.26.07.1989.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqës dhe provave të lartëcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, pasi që:

Nga Certifikata pronësore e datës 27.12.2024, gjykata vërtetoi faktin se njësia kadastrale nr. P-...-1 në sipërfaqe prej 838m<sup>2</sup> në vendin e quajtur “kopshti -zhubareviq” ZK Gjilan evidentohet në emër të M (J) M, M(J)M,A (J) M, M (J) M , pjesa e pronës 1/4.

Nga prcesverbali i dt.18.04.2019 i daljes në vendngjarje konstatohet fakti se gjykata ka dalë në vendngjarje bashkë me ekspertin gjeodet Bujar Kurteshi dhe aty ka konstatuar se ekzitojne dy shtëpi të ndërtuara të banueshme 3 katëshe, që kanë dalje në rrugen kryesore të qyteti të Gjilanit ndërsa pjesa tjetër mbrapa shtëpive ka qenë e mbjellur me pemë dhe bari artificial. Gjithashtu është konstatuar edhe pjesa prej 5 ari 18 metra, e cila fillon nga pjesa lindore dhe se është obliguar eksperti ta përkufizojë këtë pjesë të ngastrës.

Nga leximi i Aktgjykimit me shenjën C.nr.330/2000 i dt.15.01.2001, i Gjykatës Komunale ne Gjilan, u vërtetua fakti se është marë Aktgjykim në mungesë nga ana e gjykatës me të cilën është aprovuar kërkesëpadia e paditësit D M ndaj të paditurit M dhe është konstatuar se paditësi është pronarë i sip. prej 0.05.18ha, me kulturë arë e klasit të tretë në vendin e quajtur “Popovicë” si pjesë e ngastrës 593/1, e evidentuar sipas listës poseduese nr.3477 ashtu që obligohet i padituri, që këtë të drejtë t’ia njohë paditësit dhe tia, dorëzojë pronën në posedim ne afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit.

Nga Ekspertiza e gjeodezisë e dt.02.05.2019, e përpiluar nga eksperti Bujar Kurteshi, ku edhe ja ka bashkangjitur skicat, është konstatuar se ngastra me nr.593-1 evidentohet në emër të Mit, M, A dhe M që të gjithë M me nga ¼, të sipërfaqes së përgjithshme 838m<sup>2</sup>. Mbi ngastër është konstatuar se kanë qenë të ndërtuara 3 objekte banimi dhe atë B+P+2+Nk, ku është konstatuar se ishte duke banuar M M , në pjesën qëndrore është ndërtuar objekti 2P+3 ku banon M M , në pjesën perëndimore banon M M me objektin e gjysmëndërtuar P+1, ku aty banon A M.

Nga leximi i Kontrata mbi rregullimin e tokës ndërtimore me nr.01-352-1355/89 e dt.26.07.1989, u vërtetua fakti se Bashkësia Vetëqevërisëse e Interesit per Banim dhe Veprimtari Komunale e Komunës së Gjilanit ka lidhur kontratë mbi rregullimin e tokës ndërtimore me Mn si pjesëmarrës i investimeve në ndërtimin e tokës ndërtimore në pronësinë individuale. Sipas kësaj kontrate investuesi – M ishte obliguar që në emër të pjesëmarrjes në shpenzimet e rregullimit të tokës ndërtimore për m<sup>2</sup> me sip banesore, lokal afarist në ngastrën kad.593/1 të paguajë shumën prej 100.000 dinarë për m<sup>2</sup> , gjithsej 40m<sup>2</sup> në shumën e përgjithshme prej 4.000.000 dinarë ose 4 milionë dinarë të cilën shumë investuesi e kishte paguar me favor të Bashkësisë. Sipas nenit 3 të kësaj kontrate kishte lejuar investuesin që të kyqet në objekte komunale – infrastrukturë si ujësjellës , kanalizim elektrofikim dhe rrugë.

Nga Ekspertiza plotësuese e ekspertit Artan Zeneli gjeodet e datës 25.11.2024 gjykata ka konstuar se parcela kadastrale P-70403013-0593-1 me nr. 972-11, me sip prej 832 m<sup>2</sup>, me kulturë tokë ndërtimore (oborr 500 m<sup>2</sup> shtëpi- ndërtesë 142 m<sup>2</sup>) dhe bujqësore (arë e klasës 3 me sip.196m<sup>2</sup>) me pronarë juridik M (J) M 1/4, M(J) M 1/4,A (J) M1/4, M (J) M 1/4 .

- Parcela 593-1 në anën lindore, kufizohet me parcelën 2363-1, në gjatësi prej 26.37m nga pika 1 deri 2.



- Në anën jugore kufizohet me parcelën 593-12 gjatësi prej 16.43m nga pika 2 deri 3 dhe 13.21 nga pika 3 deri 4.
- Në anën perëndimore kufizohet me parcelën 595-0, në gjatësi prej 13.64m nga pika 4,5, 13.89 m nga pika 5 deri 6, 412 m nga pika 6 deri 7 5.21m dhe pika 7 deri 8.
- Në veri kufizohet me parcelën 2708-0 në gjatësi prej 21.16m nga pika 1 deri 8.

Nga leximi i Aktgjykimit i cili është marrë në mungesë, të Gjykatë Komunale në Gjilan C.nr.330/2000 i dt.15.01.2001, u vërtetua fakti se është aprovuar kërkesëpapia e paditësit D M dhe është konstatuar i njëjti është pronar i sipërfaqes prej 0.05.18 ha, në vendin e quajtur Popovicë, pjesë e ngastrës kad.593/1 , e cila është evidentuar në emër të të paditurit A M.

Nga leximi i dëshmisë e cila është nënshkruar nga M, nga përmbajtja e kësaj dëshmie, i njëjti ka deklaruar se “unë si pronar i sipërfaqes, parcelës M, ua kam shitur parcelën në vendin e quajtur Popovicë, në sipërfaqe prej 5ari e 18m, para afro 17 viteve D Mt dhe J Mt që të dyve nga 5ari, mirpo më tutje shton se pasi që J M ka bërë uzurpim të së drejtës së Dit duke e nisur shtëpinë në tërë sipërfaqen e truallit të shitur dmth në sipërfaqen prej 10 ari e 36m, e me këtë qëllim lëshoj dëshmi të cilën e nënshkruaj personalisht, ku kjo qësthej nuk është dashur të shëndrrohet në kontest, në fund të dëshmisë thotë se me rastin e shitjes së kësaj parcele të hollat ia ka marrë dy blerësve, jo vetëm nga Ji siq vepron ai i cili thotë së gjoja vet e ka blerë.

Nga leximi i Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.399/2002 i dt.06.05.2003, u vërtetua fakti se është aprovuar papia e paditësit D M si e bazuar, ndaj të paditurve e J Mt dhe është anuluar Kontrata për falje e lidhur ndërmjet dhuratëdhënësit M nga Gjilani dhe dhuratëmarrësit J M, me shenjë VR.Nr.1218/2002, e dt.15.06.2002.

Nga leximi i kopjes së planit të dt.18.03.1986, u vërtetua fakti se ngastra kadastrale është evidentuar në emër të M.

Nga leximi i aktvendimit E.Nr.157/2001 i dt.20.06.2011, u vërtetua fakti se gjykata e ka shfuqizuar Aktvendimi mbi Lejimin e Përmbarrimit duke lejuar të gjitha veprimet e ndërmara në procedurën përmbarrimroe për shkak se dokumenti përmbarrimor, ka qenë i pa përshtatshëm për përmbarrim, pasi që nuk është përkufizuar sipërfaqja e pjesës së ngastrës prej 5 ari e 18m, siq edhe ka qenë në propozim për përmbarrim, i cili propozim është ngitur për eksekutimi ne aktgjykimit të plotëfuqishëm të Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.330/2000 i dt.15.01.2001.

Nga leximi i Aktvendimit C.nr.599/02 i dt.16.02.2002, u vërtetua fakti se është konsideruar e tërhequr papia e paditësve dhe J M kundër të paditurit D M.

Nga leximi i qertifikatës së pronës me nr.1676/2019 e dt.01.03.2019, u vërtetua fakti se ngastra kad.593-1 ZK-Gjilan, në sipërfaqe prej 838m, evidentohet në emër të M M, M M, A M dhe M M të gjithë me  $\frac{1}{4}$  , të cilët janë pronar të kësaj ngastre në bazë të kontratës mbi faljen nr.2316/09 dhe në bazë të Aktvendimit të DGJKP-së, me nr.703/09 i dt.25.05.2009.

Nga leximi i Aktvendimit për regullimin e trashëgimisë të të ndjerit D M u vërtetua fakti se trashëgimtar i pasurisë së paluajtshme të lënë nga i ndjeri D M është shpallur N M.

Nga leximi i ekspertizës së ekspertit Hamdi Ismajli nga Gjilani, u vërtetua fakti se sipërfaqja e ngastrës kadastrale e cila është kontestuese 518m<sup>2</sup> e ngastrës 593-1, është vlerësuar në shumën prej 113,960.00€.

Nga leximi i ekspertizës të grupit të ekspertëve vlerësues Zeqirja Fazliu, Naim Ymeri , Bashkim Hoxha u vërtetua fakti se sipërfaqja e ngastrës kadastrale 593-1 e cila është 518 m<sup>2</sup>, është vlerësuar në qmimin prej 90.650.00€.

Nga leximi i deklaratës së palës paditëse **D M**, tani më i ndjerë i dhënë në procesverbalin e dt.16.01.2013 , u vërtetua fakti se i njëjti ka deklaruar se me të ndjerin M kishin blerë në sipërfaqe toke prej 3 ari e 35m<sup>2</sup> nga një person me emrin Miftar u, dhe pas kësaj dëshmitari dhe M kishin blerë 5 ari e 18m në shumën e përgjithshme prej 320,000.00dinar të atëhershëm jugosllav, pastaj ka deklaruar se të hollat ia kishin dhënë menjëherë blerësit ku prezent kishin qenë edhe disa persona tjerë të cilët tani kishin vdekur. Sipas marveshjes i kishte takuar pjesa në anën lindore të ngastrës kurse ut i kishte takuar pjesa në anën perëndimore dhe se të dy kishin pasur shiqimin në rrugën kryesor të Prishtinës, por që nuk kishin ndarë në kufijë asnjëherë. Para luftës J M kishte pasur një pjesë të veten të cilën e kishte blerë nga u- i ndjerë por edhe në këtë rast nuk ishte bërë ndarja me kufijë. Pastaj Ji kishte filluar të ndërtojë duke e çënuar kufirin dhe se për këtë dëshmitari D, kishte bërë padi për pengim posedim. Më tutje ka shtuar se M i ndjerë nuk e kishte blerë ngastrën si tërësi , i njëjti kishte pasur kontratë me shkrim mbi shitblerjen ndërsa dëshmitari D dhe i ndjeri nuk kishin pasur kontratë me shkrim, pasi që kishin pasur besimin reciprok në mes veti. Pastaj deklaroi se pjesën e tij nga M e kishte blerë pas 3-4 muajve por që nuk e ka thurrur dhe nuk e ka përkufizuar me asgjë. Me rastin e fillimit të ndërtimit të shtëpive nga J M , të njëjtit ia kishte tërhequr vërejtjen dëshmitari D me arsyetimin se po e ndërton në pjesën e tij. Një pjesë e parcelës kishte mbetur e lirë dhe se dëshmitari ishte në shfrytëzimin e saj por që sipërfaqen nuk e ka ditur se sa është. Me rastin e shitblerjes të shtëpisë prezent kishin qenë Xhavit Deliu nga Gjilani, Fejzullah M si dhe personat e tjerë të cilët tani ishin të vdekur ndërsa nuk kishte qenë e as djemtë e tij. Në fund shton se kur është bërë kontrata mbi faljen në mes të Mt të ndjerë dhe J Mt, dëshmitari D kishte reaguar në atë kohë dhe për këtë kishte ushtruar padi në gjykatë.

Dëshmitari **J M** në deklaratën e tij të dhënë në procesverbalin e dt.16.01.2013 kishte deklaruar se me të ndjerin M, kishin blerë një sipërfaqe të tokës prej 10 ari e 38 m, dhe vëllau i tyre Daut M në pjesë të barabarta dhe në vitin 1972, kishin shpërndarë bashkësinë familjare dhe ekonomike me vëllezërit ashtu që e tërë pasuria e paluajtshme që është objekt kontesti i kishte takuar J Mt. Me tëj ka shtuar se tani sipërfaqja e ngastrës është 8 ari e 38m ashtu që për pjesën prej 2 ari nuk e din se nga na shkuar deri sa ky ka qenë në pronësi dhe se nuk e din se a ka pasur pasuri aty D M pas iqë vëllau i tij i ndjerë M kur e ka blerë ngastrën nuk ka përmendur se aty ka blerë edhe D M. Nuk e kishte parë asnjëherë D Mn që të sillet rreth pronës së tij .

Paditësi **N M** i dëgjuar në cilësi të palës në seancën e datës 29.01.2025: Gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se fillimisht toka është blerë nga babai im **D M** dhe **M**, para përafërsisht 50 viteve, prona ka qenë me dokumente në emër të **Mt**, prona- pjesa që i ka takuar **D Mt** është pjesa lindore e ngastrës e cila ka sipërfaqen prej 5 ari e 15m. Kemi edhe vendimin gjyqësor lidhur me këtë qështje, mirëpo ky vendim nuk është zbatuar, por janë bërë matjet, procedura ka vazhduar, nuk më kujtohet se deri në cilin vit ka vazhduar procedura e përmbartimit, vendimi nuk ka mundur të zbatohet në procedurë përmbartimi dhe ne e kemi ushtruar padinë në gjykatë, në këtë ngastër e di se ka ndërtime, paraardhësi im **D M** ka zhvilluar bisedime me të paditurin në prezencën e 10 personave tjerë, mirëpo rezultat nuk kanë arritur, i njoh **M Shalën** dhe **B Mn**, të cilët kanë qenë prezent në kuadër të atyre 10 personave që i përmenda, nuk jam kompensuar asnjëherë për pjesën për të cilën pretendoj se duhet të kompensohem. Gjithashtu as babai im nuk është kompensuar asnjëherë. Asnjëherë nuk është zbatuar ndonjë procedurë trashëgimore nga paraardhësit tanë, ka pasur marrëveshje me shkrim dhe marrëveshje gojore në momentin e blerjes së ngastrës, gjykatës i kemi dorëzuar marrëveshjen me shkrim, gjithashtu mendoj se e njëjta është në shkresat e lëndës. E kemi shqyrtuar trashëgiminë e **D Mt** dhe atë në vitin 2020. Të gjitha ngastrat më kanë ra mua , të cilat kanë qenë të babait tim, gjithashtu edhe ngastra për të cilën është duke u zhvilluar kontesti me ka ra mua. Kam jetuar në **Zvicërr** , ndërsa asnjëherë në ngastrën kontestuese. Babai im **D M** nuk ka qenë investues në përgatitjen e themeleve të shtëpisë, pasi që nuk ka pasur mundësi t ë jetë sepse **J M** ka kundërshtuar qdo tentim që babai im ka ndërmarrë rreth investimit. Më kujtohet se qështje kontestuese pa qenë **Pengim Posedim**, dhe me sa di unë gjykata nuk ka mundur ta zgjidhë çështjen e pengim posedimit sepse prona nuk ka qenë ende e zgjidhur me **Mn**. Në vitin 2001 nuk ka qenë ngastra livadh andaj edhe nuk kam kërkuar asnjëherë vlerësimin e saj. Pas vitit 1985 të paditurit kanë ndërtuar shtëpi dhe e kanë kontrolluar parcelën si dhe kanë mbjella bashqë. Kur është blerë m ngastra nuk ka pasur as arra e as molla dhe nuk ka pasur as ndërtim. Nuk ka pasur vlerësim nga agronomi. Nuk kam investuar në objekte – shtëpitë. E kam dëgjuar se ngastra kontestuese 593-1 ka qenë pronë e ndërmarrjes **Mlladost**, pastaj ka qenë pronar **Miftar Shahiqi**, pastaj nga **Mlladosti** e ka blerë **Miftar Shahiqi** e i cili ua ka shitur babait tim **D M** dhe **Mt**, për këtë shitblerje nuk ka kontratë. E di se kontrata është bërë në gjykatë në emër të **Mt**. Nuk e di se për qfarë është ngritur padia në **K**. Nuk kam njohur lidhur me këto njohuri lidhur me këtë deklaratë. Nuk ka ndonjë dokument me të cilin dëshmon se prona është e babit tim. **J M** nuk ka qenë në dijeni rreth zhvillimit të procedurës. Nuk kam qenë prezent kur është blerë ngastra nga **Di** dhe u, këtë e kam kuptuar pas blerjes pasi që babai im ka treguar, e di se pazari është bërë në shtëpinë e **M** në fsh. **Busavatë-lagja Jabukovic**, çmimi i shitblerjes dhe lloji i parave me të cilat i ka paguar nuk më kujtohet, e di se babai im e ka paguar çmimin në tërësi, nuk është bërë bartja e pronës në emër të babait tim pasi që gjërat janë bërë në besim, nuk më kujtohet se a ka qenë tjetër kush prezent përpos shitësit dhe blerësve, babai im **Di** dhe u nuk kanë vendosur megje në mes, pas blerjes nuk kanë hyrë në posedim pasi që nuk ka lejuar **J M**, **Di** dhe u kanë qenë kusherinjë. Babai i **Di** emrin e ka pasur **Hasan** e ndërsa babai i **ut A**, të cilët kanë qenë kushërinj.

Dëshmitari **M Sh** nga **Gjilani** në procesverbalin e dt. 16.01.2013, kishte deklaruar se paditësin **D Mn** e ndjerë e kishte të afërm të familjes ashtuqë i është kujtuar se para 30 viteve e më shumë ksishtë dëgjuar nga **D M** se i njëjti së bashku me **Mn** kishin blerë një parcelë në **Gjilan** në vendin e quajtur “petigoc” me sip. të barabarta ashtuqë **Di** ja kishtë paguar pjesën e vet blerësit , ku me

rastin e shitblerjes kishte qenë prezent edhe vet Di. Më tutje ka dkeluar se blerja është bërë në atë formë ne pjesë të barabarta më shiqim nga rruga kryesore për të dy pronaret e ngastrës kadastrale ,ashtuqë pjesët e ngastrës kishin qenë të përcaktuara, pjesën në anën lindore e kishtë marë Di kurse pjesën në anën perëndimore e kishtë marë M, ndërsa në atë kohë kishtë dëgjuar pjesën e vet M ja kishtë shitur J Mt, ku ky i fundit ka ndërtuar në tërë sipërfaqen e tokës. Nuk e din se sa të holla i kishtë dhënë D M blerësit . Gjitha këto ifnformata dëshmitari i ka dhënë duke u bazuar në njerëzit e tjerë të lagjes.

Dëshmitari **B M** në senacën e datës 16.01.2013, kishtë deklaruar se me paditësin ishte vëlla ndërsa me të paditurit në lidhje farefisnore më tej ka deklaruar se paditësi D M tani i ndjerë pas luftës ne Kosovë në vitin 2000, e ka blerë një sipërfaqe të tokës nga M me sip. prej 5 ari, por që nuk e di se në çfarë valute është bërë shitblerja. Ndarja e ngastrës në aspektin faktik ishte bërë nga shtëpia pa dalur fare në vendngjarje dhe pa u vendsour kufiri ndarës në mes të pjesësve të ngastrës por që Dit i kishtë takuar pjesa lindore ndërsa pjesa tjetër Mt. Nuk e din faktin se a e ka kundërshtuar ndonjëherë D Mn J M gjatë ndërtimit të shtëpive.

Kjo gjykatë pasi ka administruar të gjitha provat e lartëcekura dhe thëniet e palëve ndërgjyqëse gjatë seancave të mbajtura, ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar në ligj, andaj edhe të njejtën e ka refuzuar, për shkak se paditësi me asnjë provë nuk ka arritur të vërtetoj se me çfar baze juridike bazon pretendimet e tija se duhet ti kthehet palujtshmëria respektivisht siparfaqja prej 518m2, e ngastrës kadastrale 593-1, ose ti kompenzohet kjo palujtshmëri në shumën prej 90,650.00€.

Gjykata erdhi në përfundim se paditësi asnjëher nuk e ka ushtruar pushtetin faktik dhe as juridik mbi ngastrën kontestuese, e që kjo të jetë bazë, pastaj që të kërkoj kthimin e palujtshmërisë, pasi që sipas nenit 20 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore, është paraparë se: *E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim. E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj*. Pronari duhet të provojë se mbi sendin kthimin e të cilit e kërkon, e ka të drejtën e pronësisë dhe se sendi gjendet nën zotrimin faktik të të paditurit. Nga provat e administruara dhe fakteve të vërtetuara siq janë dëgjimi i dëshmitarëve dhe dëgjimi i paditësit në cilësi të palës nuk është vërtetuar se paraardhësi i paditësit dhe paditësi ta ken ushtruar pushtetin faktik dhe juridik mbi palujtshmërinë, dëshmitarët vetëm deklarajn se kanë dëgjuar se ka ndodhur një marrveshje për shitblerjen e palujtshmërisë ku në cilësi të blerësit kanë qenë parardhësi të paditësit D M dhe Mt, e i cili pastaj ja ka shitur J M paraardhësi i të paditurëve M M, M M, A M dhe M M, e të cilët kishin ndërtuar shtëpi banimi në të cilat jetojn edhe sot, vet paditësi ndër tjera ka deklaruar se *“Nuk ka ndonjë dokument me të cilin dëshmon se prona është e babait tim”*, ndërsa J M dhe familja e tij pronën e kanë poseduar dhe shfrytëzuar për me tepër se 50 vjet, duke paguar kontributet komunale, janë pajisur me lejen e ndërtimit për ndërtimin e shtëpive etj.

Pretendimet e të paditurëve lidhur me parashkrimin e kerkesës nuk ka mbështetje ligjore pasi që e drejta e paraqitjes së padisë në qështjet që kanë të bëjnë me pronën e palujtshme, respektivisht të drejtat që burojn nga palujtshmëria, si e drejtë absolute nuk parashkruhen, kjo gjen mbështetje në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KI 121/21, Ref. Agj. 2216/23 pika 50.

Gjykata gjithshu e refuzoi kerkesën e paditësit pasi që vlersoi se nga ana e paditësit nuk janë ofruar prova bindëse, e me të cilat kishtë me u vërtetuar, bazueshmëria e kërkesëpadisë, andaj

edhe e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit në mungesë të provave edhe ate duke u bazuar në dispozitat e nenit 319.1 dhe nenin 322 pika 1 dhe 2 të LPK-ës, ku neni 319.1 ka paraparë “**secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta**”, kurse neni 322.1 ka paraparë “**në qoftëse gjykata në bazë të provave të marrura (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke aplikuar rregullat mbi barrën e provës**”, ndërsa neni 322.2 ka paraparë “**pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj po qe se ligji nuk parasheh diç tjetër**, andaj gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që e ka detyruar paditësin që në emër të shpenzimeve për përfaqësuesin e përkohshëm Av. Shabi Isufit t’i paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 2,704.00€, €, edhe atë për 4 seanca të mbajtura shumën prej 540.80€ për qdo seancë të mbajtur, për 2 seanca të treguara nga 270.40€, në shumën e përgjithshme prej 2,704.00€, , duke u bazuar në T O A K-ës.

Gjithashtu në emër të shpenzimeve të procedurës gjykata e obligoi paditësin që Av. Halit Azemit t’ia paguaj shumën prej 4,680.00€, dhe ate për 13 seanca të mbajtura 312€ dhe për tri ankesa të ushtruara nga 208€, Av. Feim Alaj, t’ia paguaj shumën prej 2,180€, për shtatë seanca të mbajtura nga 312€, dhe av. A Salihut për tre seanca të mbajtura nga 312€ dhe për një përgjegje në padi dhumen prej 208€, t’ia paguaj shumën prej 1,144.00€.

Gjykata administroi edhe provat tjera por që nuk i elaboroi, pasi që nuk ishin relevante për qështjen.

Andaj, bazuar në dispozitat e lartëcekrua dhe konform nenit 143 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN**  
**Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**  
**C.nr.437/2018 më datë 07.02.2024**

**Gjyqtari,**  
**Gazmend Ajvazi**

**UDHËZIMI JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 15 ditëve, pas ditës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëpërmjet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2020:019136  
Datë: 04.03.2025  
Numri i dokumentit: 06937685